



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1671/ 4 prot.

Datë 08/07/2025

V E N D I M
Nr. 866 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08 /07/2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me REF-51751-06-19-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03-07-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G dhe adresë: Njësia Administrative nr. 10, Rruga “Fortuzi ”, Nr. 66/1.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kolonjë.
Adresa: Sheshi “ Rilindja ”

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatori ekonomik ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20-06-2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me REF-51751-06-19-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03-07-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.

II.2. Në datën 25.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me nr. 1671/2025 prot., datë 25.06.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5476, datë 26.06.2025, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, shkresën nr. 3128/1 prot., datë 27.06.2025, me objekt “Kthim përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”. Referuar kësaj shkrese rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit,

1.Ne shtojcen Shtojca 7. Eshte percaktuar afati I levrimit 10 (dhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës. Duke patur parasysh qe te gjitha produktet objekt prokurimi jane produkte qe importohen nga furnitoret nderkombetare, si dhe duke patur parasysh kompleksitetin e procesit te transportit nderkombetar (cdo transport kerkon minimalisht 2 jave) , procedurat doganore, kontrollet ne doganat Europiane dhe ate Shqiptare, Vleresojme se afati 10 dite kalendarike I cili perkon ne rastin me te mire me 7 dite pune dhe ne rastin me te keq me vetem 5 dite pune, eshte I pa mjaftueshem. Afati I shkurter favorizon OE qe e kane mallin gjendje, dhe penalizon OE qe mund te ofertojne cmime me te mira, por qe do te duhet ta importojne produktin. Për sa me sipër kërkojmë që afati I lëvrimit te behet minimalisht 30 ditë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Blue Print Technologies” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të tenderit, sa i përket *shtojces 7* të dokumenteve të tenderit, duke kërkuar: “*modifikimin e këtj kriteri* ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shtojca 7.Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Sasia e mallit që kërkohet dhe afatet e lëvrimit paraqiten në tabelën si mëposhtë:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
-----------	------------	-------	--------------	----------------------

1	Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025	Sipas preventivit bashkëngjitur	Magazina e Bashkisë Kolonjë	10 (dhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” thuhet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me 9 dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i

kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.7. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit shtojca 7, që lëvrimi i mallit do të bëhet brenda 10 ditëve. Ky afat lëvrimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh llojin e mallit që po prokurohet, duke marrë në konsideratë se malli objekt prokurimi mund edhe të importohet nga operatorët ekonomik pjesëmarrës. Ndaj KPP gjykon, se afati i lëvrimit të mallit në rastin konkret, duhet të jetë më i gjatë në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t’ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Për rrjedhojë, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimit të mallit, në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, si më poshtë ,

2- Ne piken 2.2.2 të shtojcës 8 kerkohet: 2.2.2 Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022-2023-2024, të certifikuara nga autoritetet përkatëse , të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuara, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi. Kërkesa e mesiperme nuk është në përputhje me LPP dhe aktet nenligjore në mbështetje të tij. Procedura objekt ankimi është procedure E hapur e Thjeshtuar. Për keto procedura, LPP dhe VKM për RPP parashikon se Kriteret ekonomike financiare duhet të jenë të thjeshtuara, dhe keto të fundit provohen me paraqitjen e vertetimit të xhiros për 3 vitet e fundit. (neni 55 pika 4 I VKM 285 date 19.05.2021)

III.2.1 Autoriteti kontraktor në shtojcën 8 pika 2.2.2 , ka parashikuar në DST si në vijim ...2.2.2 Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022-2023-2024, të çertifikuara nga autoritetet përkatëse , të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivi.

III.2.1. Neni 2, Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikon shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.2 Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.3. Në nenin 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare . 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. 4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit . 5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me

objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.2.4. Në nenin 55, “**Procedurë e hapur e thjeshtuar**”, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, që mund përdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit në nenin 49, të LPP-së.
2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë në këtë procedurë.
3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 49, të LPP-së.
4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

- i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit¹ që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e kontratës.

5. Shqyrtimi i ofertave duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i ofertave.
6. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

III.2.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për heqjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.2 të DST, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.2.2 ...**2.2.2 Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare 2022-2023-2024, të çertifikuara nga autoritetet përkatëse , të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes së bilanceve nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, gjithashtu të jenë , të çertifikuara nga autoritetet përkatëse , të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Sa më sipër, referuar llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht "Procedurë e hapur e thjeshtuar", legjislacioni parashikon që autoritet/entitet kontraktore duhet të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet të marrë masa për të hequr kriterin e kërkesës së dorëzimit të kopjeve të bilanceve të çertifikuara, që plotësimi i këtyre kërkesave të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.**

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Blueprint Technologies" SHPK, për modifikimin e dokumenteve të tenderit, si më poshtë,

3- Në pikën 2.3.2/b të shtojcës 8 kërket: 2.3.2/b Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin edhe deklaratat si më poshtë: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve sipas specifikimeve teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Anketa jone I referohet pjesës së fundit të kësaj kërkesë dhe mirëmbajtjen e tyre Produktet objekt prokurimi, janë pajisje elektronike të cilat duhet të mirembahen sipas manualit të prodhuesit, për të garantuar funksionimin për një kohë sa më të gjatë. Psh, printerat dhe fotokopjet kanë nevojë për mirëmbajtje periodike, zëvendësim pjesë konsumi si Tonera, Drum, Fuser , gomina etj. Këto shërbime mirëmbajtjeje duhet të jenë procedure me vete dhe nuk mbulohen nga garancia standarte e pajisjeve.

Për sa më sipër, kërkojmë heqjen e mirëmbajtjes nga pika 2.3.2/b

III.3.1 Autoriteti kontraktor në shtojcën 8 pika 2.3.2 B , ka parashikuar në DST si në vijim 2.3.2/b Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve sipas specifikimeve teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

III.3.2 Autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit ka parashikuar shtojcën:

PREVENTIV

Objekti: Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025

Investitori : Bashkia Kolonjë.

Periudha : Viti 2025

NR EMËRTIMI I MALLRAVE NJËSIA SASIA ÇMIMI VLEFTA

1 UPS 1000VA copë 12; 2 KOMPJUTERA Ëorkstation Advanced (Sipas Prodhuesit) copë 2; 3 FOTOKOPJE Multifunction Color MFP Basic copë 1 ; 4 KOMPJUTERA Desktop 2 copë 10; 5 FOTOKOPJE Multifunction B&Ë MFP Basic copë 1; 6 PROJEKTOR Tipi 2 copë 1; 7 PRINTER All In One B&Ë copë 9; 8 Laptop Praktik copë 1 ; 9 Sëitch me 5 porta copë 2 Shuma pa Tvsh

Tvsh-ja

Shuma me Tvsh

III.3.3. Neni 2, Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikon shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.4. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt-prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

III.3.6. Komisioni i prokurimit publik gjykon se në lidhje me kriterin e vendosur nga AK *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve sipas specifikimeve teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Komisioni i prokurimit publik . vlerëson se duke iu referuar objektit të prokurimit i cili është “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera” kërkesat e autoritetit kontraktor duhet të bëhen duke ju referuar vetëm objektit dhe gjithmonë në proporcion me të. Kriteri i vendosur për kualifikim si në vijim “2.3.2/b Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin edhe deklaratat si më poshtë:*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve sipas specifikimeve teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre”, gjithashtu rezulton se nuk është i argumentuar dhe arsyetuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë, autoriteti kontraktor nuk duhet të mjaftohet me vetëm me citime bazike ligjore si në vijim:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është gjykuar si kriter i domosdoshëm, pasi garancia e mallrave jep siguri për furnizime cilësore dhe e bën operatorin ekonomik fitues me të përgjigjshëm për produktet që oferton.

Komisioni i Prokurimit Publik e gjenë me vend të qartësojë se objekti i prokurimit është “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera”, gjithashtu referuar verifikimeve të zërave të preventivit rezulton se tipi i kontratës është “Mall” ndërkohë kërkesa e kriterit të kërkuar në DST shtojca 8, pika 2.3.2, gërma b nga autoriteti është, [... dhe mirëmbajtjen e tyre].” kërkesë e cila nuk lidhet me tipin e kontratës “Mall”.

Për sa më sipër Komisioni prokurimit publik e gjen me vend kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për t'u hequr pjesën e mirëmbajtjes të pajisjeve të parashikuara në pikën 2.3.2 pika b.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-51751-06-19-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike, fotokopje dhe printera për vitin 2025”, me fond limit 3,331,809.00 lekë pa TVSh, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03-07-2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kolonjë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fioorent Zguro

